



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Mars 2021

Nr: 141

VENDIM

**PËR CAKTIMIN E VENDNDODHJES SË DISA QENDRAVE TË VOTIMIT NË
NDËRTESA PRIVATE**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 93 paragrafët 2 dhe 3, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N

Referuar nenit 93, paragrafët 2 dhe 3, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 3, paragrafët 3 dhe 4, të Udhëzimit të Komisionit Rregullator nr.1, datë 05.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetqeverisjes vendore për zgjedhjet”, KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje.

Kryetari i njësisë së vetqeverisjes vendore, i propozon KQZ-së caktimin e qendrës së votimit në ndërtesë private në pronësi të personave fizikë ose juridik, duke paraqitur dy objekte alternative, planimetrinë përkatëse ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve, si dhe të dhëna të tjera për efekt të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor. Në rastet kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ, KQZ-së i paraqitet propozimi dhe të dhënat e kërkuara vetëm për një objekt.

Në KQZ janë administruar propozimet e kryetarëve të njësisë të vetqeverisjes vendore për caktimin e vendndodhjeve të 61 qendrave të votimit në ndërtesa private, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Nga shqyrtimi i të dhënave në dokumentacionin e administruar, rezulton se propozimet



përmbushin kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr.1, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, nenet 3 dhe 4 të tij:

- nuk përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike, kandidati, të afërmeve të tij, ose kanë shërbyer si zyra elektorale gjatë fushatës zgjedhore;
- janë me sipërfaqe, jo më të vogël se 30 m²;
- janë afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit;
- janë me ndriçim të mjaftueshëm;
- janë, përgjithësisht në katet e para të objekteve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, paragrafi 2, nenin 93 paragrafët 2 dhe 3, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 3, të Udhëzimit të Komisionit Rregullator nr.1, datë 05.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”,

VENDOSA:

1. Caktimin e vendndodhjeve të qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur.
2. Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore të kryejë menjëherë njoftimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjen e qendrës së votimit, të caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Qarku	Bashkia	Nr.	Njësia Adm	QV	Vendndodhja QV		
Shkodër	Shkodër	1	Velipojë	0331	Rruga Kol Dashi, Bar kafë Gjovalin Shehu		
Lezhë	Lezhë	2	Lezhë	714/2	Shëngjin, ambient shërbimi Pal Vataj		
		3	Lezhë	712/1	Shëngjin, ambient shërbimi Rita Gilaj		
	Kurbën	4	Milot	871	Fushe-Milot, njësi shërbimi Leonard Kola		
Dibër	Dibër	5	Tomin	1158	Fshati Brezhdan, ambjent shërbimi Rushit Domazeti		
		6	Xibër	965	Ambjent shërbimi Ajet Muça		
Durrës	Krujë	7	Nikël	1287	Fshati Zezë, ambjent shërbimi Hasan Stafuka		
		8	Fushë Krujë	1295/1	Fshati Fushë Krujë, Lgj.Re, ambient shërbimi Maliq Veshti		
Tiranë	Kamëz	9	Kamëz	1590	Rruga Durrësi ,objekt shërbimi Fasli Abazi		
		10	Kamëz	1590/1	Rruga Durrësi ,objekt shërbimi Fasli Abazi		
		11	Kamëz	1573	Rruga Nazmi Kryziu, objekt arsimor privat Valbona Kërçiku		
		12	Kamëz	1573/1	Rruga Nazmi Kryziu, objekt arsimor privat Valbona Kërçiku		
		13	Kamëz	1573/2	Rruga Nazmi Kryziu, objekt arsimor privat Valbona Kërçiku		
		14	Kamëz	1573/3	Rruga Nazmi Kryziu, objekt arsimor privat Valbona Kërçiku		
		15	Kamëz	1573/4	Rruga Nazmi Kryziu, objekt arsimor privat Valbona Kërçiku		
		16	Kamëz	1574	Rruga Nazmi Kryziu, objekt arsimor privat Valbona Kërçiku		
		17	Kamëz	1574/1	Rruga Nazmi Kryziu, objekt arsimor privat Valbona Kërçiku		
		18	Kamëz	1589	Rruga Lura, nr. 36, ambient shërbimi Veli Miha		
		19	Kamëz	1589/1	Rruga Lura, nr. 36, ambient shërbimi Veli Miha		
		20	Kamëz	1589	Rruga Lura, nr. 34, ambient shërbimi Besim Koka		
		21	Paskuqan	2040/2	Rruga Demokracia, lokal Pëllumb Cani		
		22	Paskuqan	2040/3	Rruga Demokracia, lokal Pëllumb Cani		
		23	Paskuqan	2041	Rruga Unaza e madhe, lokal Abaz Maçi		
		24	Paskuqan	2041/1	Rruga Unaza e madhe, lokal Abaz Maçi		
		25	Paskuqan	2041/2	Rruga Unaza e madhe, lokal Abaz Maçi		
		26	Paskuqan	2041/3	Rruga Unaza e madhe, lokal Abaz Maçi		
		27	Paskuqan	2048	Rruga Azem Hajdari, objekt shërbimi Martin Dede Rushaj		
		28	Paskuqan	2048/1	Rruga Azem Hajdari, objekt shërbimi Martin Dede Rushaj		
		29	Paskuqan	2049	Rruga "Halit Haxhia", objekt shërbimi Esta Çausi		
		30	Paskuqan	2049/1	Rruga "Halit Haxhia", objekt shërbimi Esta Çausi		
			Tiranë	31	Nj.Adm nr.2	1716	Rruga Mihal Grameno, ambient shërbimi Besim Xhabafti
				32	Nj.Adm nr.2	1716/1	Rruga Mihal Grameno, ambient shërbimi Besim Xhabafti
				33	Nj.Adm nr.2	1722/1	Rruga,Fuat Toptani, bar kafë, Hyzer Biba
				34	Nj.Adm nr.5	1854	Rr.Ilira Dilosheperi, bar kafë Myslym Dervishi
				35	Nj.Adm nr.5	1854/1	Rr.Ilira Dilosheperi, bar kafë Myslym Dervishi
				36	Nj.Adm nr.5	1855	Rr.Ilira Dilosheperi, ambient shërbimi Myslym Dervishi
				37	Nj.Adm nr.5	1855/1	Rr.Ilira Dilosheperi, ambient shërbimi Myslym Dervishi
				38	Nj.Adm nr.8	1942	Rr.Siri Kodra, lokal Myftar Xhana
		39		Nj.Adm nr.8	1942/1	Rr.Siri Kodra, lokal Myftar Xhana	
		40		Nj.Adm nr.8	1942/2	Rr.Siri Kodra, lokal Myftar Xhana	
		41		Nj.Adm nr.8	1944	Rr."Jashar Erebara" lokal Mentor Koçi	
		42		Nj.Adm nr.8	1944/1	Rr.Jashar, Erebara lokal Mentor Koçi	
		43		Nj.Adm nr.8	1944/2	Rr. "Jashar Erebara", nr. 53, ambient shërbimi Albert Morava	
		44		Nj.Adm nr.8	1945	Rr.Pandi Stillo, lokal Paulin Mema	
		45		Nj.Adm nr.8	1945/1	Rr.Ymer Beqiri, lokal Paulin Mema	
		46		Nj.Adm nr.9	1976	Rr.Riglata, ambient shërbimi Endrit Lala	
		47		Nj.Adm nr.9	1976/1	Rr.Riglata, ambient shërbimi Endrit Lala	
		48		Nj.Adm nr.11	2003	Rr.At Zef Valentin, lokal Agim Tabaku	
		49		Nj.Adm nr.11	2003/1	Rr.At Zef Valentin, lokal Agim Tabaku	
		50		Nj.Adm nr.11	2003/2	Rr.At Zef Valentin, lokal Agim Tabaku	
		51		Kashar	1538	Rr.Hoxha Fabrika Qelqit, ambient shërbimi Vaid Hoxha	
		Kavajë	52	Kavajë	2177/1	Rr.Kosova, lokal privat "Gentjan Sufaj"	
	Fier	Lushnjë	53	Lushnjë	2864	Lagja "18 Tetori", ambjent shërbimi Agron Licka	
			54	Lushnjë	2864/1	Lagja "18 Tetori", ambjent shërbimi Agron Licka	
		Fier	55	Dërmenas	3150	Fshati Havaleas, ambjent shërbimi Petraq Lina	
	Vlorë	Vlorë	56	Vlorë	4476	Lagja "24 Maj", Rr.Hasan Tasimi, "KLEAL" shpk, Klea Muskaç	
			57	Vlorë	4482	Lagja "24 Maj", Rr.Hasan Tasimi, "KLEAL" shpk, Klea Muskaç	
			58	Vlorë	4482/1	Lagja "24 Maj", Rr.Hasan Tasimi, "KLEAL" shpk, Klea Muskaç	
59			Vlorë	4505	Lagja "Uji i Ftoht", Rr.Murat Terbaci, ambjent shërbimi Kajtaz Likaj		
60			Vlorë	4505/1	Lagja "Uji i Ftoht", Rr.Murat Terbaci, ambjent shërbimi Kajtaz Likaj		
		61	Vlorë	4505/2	Lagja "Uji i Ftoht", Rr.Murat Terbaci, ambjent shërbimi Kajtaz Likaj		